Interreg Europe
Co-funded by the European Union
RESILIENT TREES

BULETININ
N#03 TETOR 2026

RESILIENT TREES

PUNOJMË SË BASHKU PËR TË PËRMIRËSUAR RUAJTJEN E PYJEVE TË VJETËR DHE DRURËVE TË MOÇËM



Objektivi i projektit RESLIENT TREES është rritja e mbrojtjes së biodiversitetit, vënia me sukses në praktikë e politikave të përmirësuara lidhur me sfidat që përballen pyjet e moçëm dhe drurët monument natyre. Nëpërmjet partneritetit sinergjik ndërmjet autoriteteve të politikave, institucioneve shkencore dhe OJQ-ve, do të promovojmë krijimin e një rrjeti kyç të burimeve pyjore duke rritur qëndrueshmërinë e peizazheve tona. Projekti RESILIENT TREES do të ruaj biodiversitetin pyjor, pëmes identifikimit të diversitetit të rajoneve evropiane ku janë lokalizuar pyjet e vjetër, drurët monument natyre dhe nga rezervatet pyjore me vlera të larta konservuese te peizazhet kulturore.



KOOPERIMI NDËR-RAJONAL



PARTNERITETI NDËR-AKTORIAL



TRANSFERIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

Regjistrohuni për buletinin



VIZITA STUDIMORE NË KAUNAS

Në datat 23–25 shtator 2026, në qytetin e **Kaunasit**, Lituani, u zhvillua vizita e dytë studimore e projektit RESILIENT TREES, financuar nga programi Interreg Europe. Në këtë aktivitet morën pjesë 35 përfaqësues nga nëntë vendet partnere, tre autoritete të asociuara dhe organizata të ndryshme që veprojnë në Lituani dhe janë të angazhuara në partneritetin shumëpalësh të projektit.

Vizita studimore konfirmoi rëndësinë e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave në adresimin e sfidave që lidhen me mbrojtjen e biodiversitetit. Përvoja e Lituanisë tregoi se si legjislacioni, kërkimi shkencor, pjesëmarrja e publikut dhe menaxhimi adaptiv mund të ndërthuren për të siguruar mbrojtjen afatgjatë të drurëve monumente natyrore dhe pyjeve të virgjër, si dhe të vlerave të jashtëzakonshme të biodiversitetit që këto ekosisteme mbështesin.

ZONAT E MBROJTURA TË LITUANISË

Masat për ruajtjen e natyrës përfshijnë integrimin e instrumenteve të menaxhimit, ndërhyrjet për rigjenerimin e ekosistemeve dhe angazhimin e publikut. Kjo qasje ndihmon në përballimin e sfidave mjedisore dhe të qeverisjes, të cilat vijnë duke u shtuar.

Agnė Jasinavičiūtė-Trakimienė (VSTT) hapi takimin me një prezantim të përgjithshëm të sistemit të zonave të mbrojtura të Lituanisë, i cili mbulon rreth 18,5% të sipërfaqes së vendit.



Këto zona luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit, peizazhit dhe trashëgimisë kulturore, si dhe krijojnë mundësi për kërkimin shkencor dhe edukimin mjedisor.

Co-funded by the European Union
Interreg Europe
RESILIENT TREES
2026

RREGULLAT E REJA PËR MENAXHIMIN E DRURËVE MONUMENT NATYRE



Martynas Survila (VSTT) prezantoi përditësimet më të fundit të rregulloreve që përcaktojnë mbrojtjen dhe menaxhimin e drurëve të shpallur objekte të trashëgimisë natyrore. Dispozitat e reja i kushtojnë rëndësi vlerësimit paraprak të ndërhyrjeve dhe punimeve silvikulturore, për të përcaktuar masat e nevojshme në përputhje me statusin e mbrojtjes dhe vlerat ekologjike të secilit dru. Rregulloret e rishikuara parashikojnë gjithashtu inventarizimin e mikrohabitateve dhe dallimin ndërmjet procesit natyror të plakjes së drurit dhe gjendjes së tij fiziologjike.

Këto rregulla synojnë edhe uljen e ndikimit të infrastrukturës së afërt mbi drurët dhe sistemin e tyre rrënjor. Ndër masat e parashikuara përmenden krijimi i një zone mbrojtëse përgjatë projeksionit të kurorës, me një rreze minimale prej 5 metrash, si dhe ruajtja e shtresës së gjetheve nën kurorën e drurit. Menaxhimi i drurëve të vjetër kërkon trajtimin e dy çështjeve kryesore:

- Siguria publike: Vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet në mënyrën e duhur. Kur është e mundur, shtigjet dhe infrastruktura rrugore duhet të përshtaten për të mbrojtur sistemin rrënjor të drurëve përpara kryerjes së ndërhyrjeve silvikulturore;
- Ruajtja e funksioneve ekologjike: Kjo kërkon monitorimin dhe mirëmbajtjen e zgavrave të drurëve, drurëve të tharë ose të kalbur, si dhe të llojeve që formojnë bashkësi ekologjike me ta. Këto elemente duhet të ruhen kur kjo është në përputhje me vlerësimet e rrezikut përkatës si dhe nevojat e ruajtjes së llojeve në habitatin e tyre natyror.

SI MUND TË IDENTIFIKOHEN PYJET E VIRGJËR NË EVROPËN VERIORE?



Gediminas Brazaitis (VDU) prezantoi këndvështrimin e Evropës Veriore mbi kriteret praktike për identifikimin e pyjeve të vjetër. Për shkak të dinamikës së zhvillimit të tyre, këto pyje nuk mund të identifikohen vetëm në bazë të moshës së drurëve.

Diskutimi u mbështet në studime të kohëve të fundit, të publikuara në revistat Ambio dhe Wisdom Letters, të cilat sugjerojnë se identifikimi duhet të bazohet në një kombinim të karakteristikave ekologjike dhe strukturore. Ndër to përfshihen prania e llojeve drunore autoktone, drurët me përmasa të mëdha dhe sasia e konsiderueshme e drurëve të tharë ose të kalbur. Të marra së bashku, këto karakteristika pasqyrojnë proceset afatgjata të zhvillimit natyror të pyjeve.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe vlerave të ruajtjes së sipërfaqeve të vogla pyjore të mbetura. Për shkak të fragmentimit historik në disa rajone, sipërfaqet e pyjeve të virgjër mund të jenë të kufizuara. Megjithatë, edhe kur zënë sipërfaqe të vogla, këta grumbuj pyjorë mund të strehojnë lloje me kërkesa të veçanta ekologjike dhe vlera të larta të ruajtjes, si dhe të shërbejnë si hallka të rëndësishme të lidhjes ekologjike në peizazh.



PËRVOJA INOVATIVE E FONDACIONIT SENGIRĖ

Adelė Banelienė prezantoi veprimtarinë e Fondacionit të Drurëve të Moçëm (Sengirės Fondas), një prej aktorëve të përfshirë në projekt. I krijuar në vitin 2020, fondacioni ka blerë dhe mbron në mënyrë të përhershme pyje me vlera të larta të ruajtjes së natyrës. Pyjet e blera përmes donacioneve i kushtohen ruajtjes së natyrës, kërkimit shkencor dhe krijimit të mundësive për vizita nga komuniteti. Deri më tani, fondacioni ka arritur të blejë 435 hektarë pyje. Kjo nismë mbështetet nga një fond që ka arritur në më shumë se 2,7 milionë euro.

IAktivitetet e para të monitorimit kanë evidentuar disa lloje kërpudhash dhe insektesh të gjinisë të skolitëve, të raportuara për herë të parë në Lituani. Termi lituanez *Sengirė*, që do të thotë "pyll i virgjër", është përhapur në përdorimin e përditshëm me një kuptim shumë pozitiv, duke ndihmuar në rritjen e mbështetjes për përpjekjet që synojnë ruajtjen e këtyre pyjeve.

Co-funded by the European Union
Interreg Europe
RESILIENT TREES
2026

PROJEKTI LIFE OSMO BALTIC DHE RUAJTJA E LLOJIT *OSMODERMA BARNABITA*



Alvydas Gintaras, nga Fondi Lituanez për Natyrën, prezantoi projektin LIFE Osmo Baltic, i cili synon ruajtjen e llojit *Osmoderma barnabita* Motschulsky, 1845. Projekti përfshin menaxhimin e një rrjeti ekologjik prej të paktën 3 374 km, që shtrihet nga Lituania në Letoni, si dhe lëshimin në natyrë të individëve të rritur (Imago) në kushte laboratorike.

Për të siguruar ruajtjen e këtij lloji, nevojitet mirëmbajtja e drurëve në faza të ndryshme të zhvillimit brenda grumbujve pyjorë ku ai është i pranishëm. Kjo qasje synon të sigurojë vazhdimësinë e zgavrave të përshtatshme të drurëve, të cilat janë të rëndësishme për ciklin e jetës së llojit. Suksesi i kësaj nisme varet gjithashtu nga bashkëpunimi i ngushtë me pronarët e pyjeve private, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së masave të ruajtjes edhe pas përfundimit të projektit.



LISI I KARVELIAS – OBJEKT I TRASHËGIMISË NATYRORE BOTANIKE

Lisi i Karvelias (*Quercus robur* L.) është një nga dushqet e rrallë në Lituani me perimetër trungu mbi 7 metra, lartësi rreth 17 metra dhe moshë të vlerësuar afërsisht 700 vjet. Ky lis ka mbijetuar ndaj disa përpjekjeve për prerje. Rasti më i fundit i përmendur daton rreth 150 vjet më parë, kur druri ishte përzgjedhur si burim i mundshëm lënde drusore për ndërtimin e një ure të njohur si "Ura e Aleksotas". Lisi u shpall monument natyre në vitin 1968 dhe monument me rëndësi kombëtare në vitin 1987. **Tadas Vaidelys** (VDU), së bashku me **Tadas Norkus** (Ardas medžių priežiūra), prezantuan gjendjen e tij aktuale vegjetative dhe shenjat e kalbjes të vërejtura gjatë pesë viteve të fundit. Këto ndryshime janë të lidhura me ndërhyrjet e kryera në zonën në afërsi të drurit.

MBROJTJA E DRURËVE VETERANË NË ZONAT URBANE



Një pjesë e rëndësishme e vizitës në terren u zhvillua në Parkun Urban me Dushk të qytetit të Kaunasit, i paraqitur si më i madhi i këtij lloji në kontinentin evropian. Parku mbulon rreth 84 hektarë dhe përmban afërsisht 770 drurë lisi. Kjo trashëgimi natyrore përbën habitat për lloje të rralla dhe të mbrojtura, përfshirë *Osmoderma barnabita*, si dhe kërpudha saproksilike si *Fistulina hepatica, Grifola frondosa* dhe *Hapalopilus croceus*. Bashkia e Kaunasit ka zbatuar për herë të parë në Lituani një kërkesë të posaçme, sipas së cilës punimet për mirëmbajtjen e drurëve të mëdhenj duhet të kryhen nën mbikëqyrjen e një eksperti mjedisor. **Arvydas Rutkauskas** (Shoqata e Dendrologëve të Lituanisë) dhe **Kęstutis Armolaitis** (Instituti i Pyjeve, Qendra Kërkimore Shkencore për Bujqësinë dhe Pyjet), shpjeguan masat e zbatuara për përmirësimin e aksesit të publikut në park, duke ruajtur njëkohësisht vlerat ekologjike të tij. Vëmendje e veçantë iu kushtua projektimit dhe ndërtimit të një rrjeti të ri shtigjesh, me synimin për të minimizuar dëmtimin e sistemit rrënjor të drurëve, si dhe hartimit të programeve afatgjata të monitorimit.

Përvoja e prezantuar evidentoi lidhjen e ngushtë ndërmjet gjendjes së pyjeve, pjellorisë së tokës dhe praktikave të menaxhimit. Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë e integrimit të ekspertizës ekologjike në planifikimin urban dhe në proceset e rigjenerimit natyror.

Co-funded by the European Union
Interreg Europe
RESILIENT TREES
2026

REZERVATI NATYROR STRIKT I MBROJTUR PUNIOS ŠILAS, NË PARKUN RAJONAL NEMUNAS LOOPS

Vizita në terren u përmbyll me një tur në Rezervatin Natyror Strikt të Mbrojtur Punios Šilas, nën drejtimin e **Žydrūnas Preikša** (VDU). Punios Šilas është një nga zonat e mbrojtura më të vjetra në Lituani, me status mbrojtjeje që prej vitit 1945. Ai karakterizohet nga grumbuj pyjorë që ruajnë shumë prej veçorive të pyjeve relikte të Lituanisë, përfshirë drurë me përmasa të mëdha, drurë të vjetër, sasi të konsiderueshme drurësh të tharë ose të kalbur dhe një diversitet të pasur habitatesh natyrore. Në disa pjesë të rezervatit nuk është kryer asnjë shfrytëzim pyjesh që nga viti 1969. Kjo ka mundësuar vazhdimin e proceseve ekologjike natyrore dhe zhvillimin e strukturave pyjore që i bëjnë këto habitate unike dhe të rralla në peizazhin pyjor evropian. Në këto pyje janë identifikuar 14 lloje habitatesh me interes për Komunitetin Evropian, që mbulojnë më shumë se 1700 hektarë. Zona strehon gjithashtu shumë lloje të mbrojtura kërpudhash, likenesh, myshqesh, bimësh, insektesh, shpendësh dhe gjitarësh. Nga kërkimet entomologjike të kryera në vitin 2024 janë evidentuar 570 lloje skolitësh, 28 prej të cilëve janë dokumentuar për herë të parë në Lituani. Pyjet përfaqësojnë gjithashtu një pasuri të rëndësishme gjenetike, ku përfshihen hartina, pisha e bardhë (*Pinus sylvestris* L.) dhe hormoqi (*Picea abies* (L.) H. Karst.), të cilat rriten në luginën e Nemunasit. Këto popullata autoktone konsiderohen burime gjenetike me rëndësi kombëtare dhe evropiane.













SHKËMBIMI I POLITIKAVE TË NIVELIT TË LARTË ME PARTNERËT

Duke u mbështetur në një qasje të zhvilluar nga një projekt tjetër i programit Interreg Europe (HR4ALL), mëngjesi i ditës së fundit iu kushtua një sesioni për shkëmbimin e politikave në nivel të lartë, me fokus instrumentet e politikave që trajton projekti RESILIENT TREES. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutonin në takime dypalëshe sfidat kryesore me të cilat përballen në proceset e përmirësimit të politikave në vendet e tyre. Përpara zhvillimit të sesionit, për secilin vend ishin identifikuar deri në tri sfida prioritare. Këto çështje u trajtuan në sesione të veçanta diskutimi, secila me kohëzgjatje prej 15 minutash. Kjo metodë rezultoi efektive në lehtësimin e shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe zgjidhjeve praktike ndërmjet partnerëve të projektit. Diskutimet theksuan vlerën e bashkëpunimit si një instrument konkret për përmirësimin e politikave publike dhe adresimin e sfidave të përbashkëta në mbrojtjen e pyjeve dhe të biodiversitetit.









Co-funded by the European Union
Interreg Europe
RESILIENT TREES
2026

Resilient Trees Newsletter

2026

PRAKTIKA TË MIRA PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE BIODIVERSITETIT

Zbuloni më shumë duke vizituar faqen tonë të internetit.

Managing veteran tree microhabitats for saproxylic hoverflies and associated biodiversity

GREEN Biodiversity preservation



Inventory and conservation of monumental trees using species-specific diameter threshold criteria

GREEN Biodiversity preservation



Harmonizing cork extraction with the breeding of large birds (birds of prey, storks, herons)

GREEN Biodiversity preservation





Na ndiqni në rrjetet sociale

in YouTube

www.interregeurope.eu/resilient-trees

resilient.trees@cnr.it

Mund të çregjistroheni në çdo kohë duke iu përgjigjur thjesht "Çregjistrohuni" këtij email-i.

Interreg Europe
Co-funded by the European Union
RESILIENT TREES

CNR IBE Istituto per la BioEconomia · Regione Piemonte · ICNF Instituto da Conservação da Natureza e das Florestas · Universidade de Évora · Ministerstvo životního prostředí · Czech University of Life Sciences Prague · Vytauto Didžiojo Universitetas · Agjencia Kombëtare e Pyjeve · PSEDA - ILIRIA · Hlavné mesto SR Bratislava · BROZ